

Objekti: **Vlerësimi i performancës për kohëzgjatjen e procesit gjyqësor**

Subjekti: **Gjyqtarja e Gjykatës Administrative të Apelit, Lindita Sinanaj**

Viti: **2017 dhe 2016**

Status: **Vlerësim Nominal (faktik-deskriptiv)**

I. Hyrje

INFOCIP ka vlerësuar përmes analizës së të dhënave performancën profesionale të Gjyqtarjat Lindita Sinanaj, anëtar i Gjykatës Administrative të Apelit. Vlerësimi profesional fokusohet tek efienca e shqyrtimit gjyqësor prej saj.

Të dhënat janë grumbulluar, përpunuar dhe analizuar nga INFOCIP gjatë dy viteve të fundit, në kuadër të Programit Kombëtar të Monitorimit të Gjykatave.

Raporti Vlerësues Nominal për Gjyqtarjan e Gjykatës Administrative të Apelit , Lindita Sinanaj mat dhe vlerëson specifikisht treguesit për kohëzgjatjen e shqyrtimit gjyqësor gjatë vitit 2016 dhe 2017. Matja e kohëzgjatjes fillon nga momenti i regjistrimit të rekursit deri në vendimin e çështjes gjyqësore. Po ashtu, Vlerësimi Nominal mat kohën e arsyetimit dhe dorëzimit në sekretari të vendimeve për rekursin ku Gjyqtarja në fjalë ka qenë relator i çështjes gjyqësore.

Gjithashtu, pjesë e kësaj Vlerësimi Nominal është edhe ngarkesa gjyqësore dhe frekuenca e vendimit nga subjekti i vlerësimit, për të ofruar një panoramë më të qartë edhe të arsyeve të vonësve eventuale që mund të konstatohen nga vlerësimi.

II. Ngarkesa Gjyqësore, 2017

Gjykata Administrative e Apelit dha gjithsej 5546 vendime gjyqësore themeli në vitin 2017. Gjyqtarja Lindita Sinanaj rezulton se ka dhënë 463 vendime për çështje themeli në këtë gjykatë gjatë vitit 2017. Nga analiza e këtyre të dhënave rezulton se Gjyqtarja Lindita Sinanaj ka vendimuar rreth 8.3% të totalit të çështjeve të themelit në vitin 2017.

Gjyqtarja Lindita Sinanaj ka vendimuar gjatë vitit 2017 me një frekuencë prej 38.5 çështje gjyqësore në muaj mesatarisht¹ (dosje të relatuara prej saj). Frekuenca e Gjykatës Administrative të Apelit për vendimet e çështjeve të themelit në 2017-ën rezulton të jetë rreth 462.1 çështje në muaj. Ngarkesa shpërndahet kryesisht mbi 13 anëtarë. Me një përllogaritje të thjeshtë, ngarkesa mesatare për secilin gjyqtar, për vendimet e çështjeve të themelit, është 35.5 çështje në muaj.

Kjo frekuencë, e përllogaritur vetëm për çështjet e themelit, e pozicion atë mbi mesataren e GJAA.

III. Kohëzgjatjen e shqyrtimit gjyqësor, 2017

Ligji Nr. 49/2012 *“Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, i ndryshuar, parashikon 30 ditë afat për shqyrtimin a ankimit gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit (neni 48²).

Nga vlerësimi i ndërmarrë, rezulton se mesatarja e shqyrtimit gjyqësor nga Gjyqtarja Lindita Sinanaj për çështje themeli të vendimuara prej saj në 2017 rezulton të jetë 630.9 ditë. Kohëzgjatja e shqyrtimit në këtë rast përllogaritet nga data e regjistrimit të ankimit në regjistrat e GJAA deri në datën e vendimit të saj.

Nga kontrastimi i të dhënave të mësipërme kemi një tejkalim të kësaj afati me reth **600.9 ditë**, ose rreth 20 herë krahasuar me afatin që cakton neni 48, paragrafi 2, i ligjit 49/2012, të ndryshuar.

¹ Mesatarja e vendimit në këtë rast përllogaritet si shpërndarje në 12 muajt e vitit të totalit të çështjeve. Për thjeshtësi metodologjike, muaji Gusht, I cili si rregull është muaj pushimi për gjykatën është i përfshirë me këtë mesatare, pasi ngarkesa e saj shpërndahet si rregull në muajt paraardhës dhe pasardhës..

² Neni 48 **Ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit, paragrafi 2** : Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi.

Mesatarja e kohëzgjatjes së shqyrtimit gjyqësor për të gjitha vendimet e themelit të dhëna nga Gjykata Administrative e Apelit në vitin 2017 rezulton të jetë 677.7 ditë. Krahasimi midis këtyre dy të dhënave³ indikon se Gjyqtarja Lindita Sinanaj nuk ka konsumuar dite më shumë se sa mesatarja e gjithë GjAA për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor gjatë 2017-ës.

Vonesa më e theksuar në shqyrtim gjyqësor në 2017-ën përkon me vendimin nr.1212, vendimuar nga Gjyqtarja në fjalë. Sipas të dhënave të disponuara nga INFOCIP, kjo çështje është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datë 19.04.2014 dhe është vendimuar në dt. 23.03.2017, pra pas 1069 ditësh, ose rreth 2.9 vjet. Me fjalë të tjera, afati ligjor i parashikuar në ligj është tejkaluar me 35.6 herë.

Dosja e shqyrtuar më shpejt nga Gjyqtarja Lindita Sinanaj është ajo me nr.akti 6837/4391/545, regjistruar në datë 01.04.2017 dhe e vendimuar brenda 19 ditësh, në dt.24.04.2017.

[Tabela 1](http://www.gjykataehapur.al) në www.gjykataehapur.al ofron të dhëna të detajuara për kohëzgjatjen e shqyrtimit gjyqësor të çështjeve të vendimuara nga Gjyqtarja Lindita Sinanaj në vitin 2017, të renditura nga më e vonuara e deri tek më pak e vonuara.

IV. Kohëzgjatja e dorëzimit të vendimit, 2017

Ligji Nr. 49/2012 *“Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar*, parashikon 7 ditë afat për dorëzimin e vendimit të arsyetuar në sekretarinë e GjAA. Neni 55 parashikon shprehimisht se vendimi, pavarësisht formës së gjykimit, duhet të shpallet detyrimisht i arsyetuar (paragrafi 1) dhe se, brenda 7 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore (paragrafi 3).

Sa i takon afatit të arsyetimit/dorëzimit në sekretari të dosjes së vendimuar, rezulton se Gjyqtarja Lindita Sinanaj ka një mesatare prej 14.1 ditësh gjatë vitit 2017. Kjo e dhënë sugjeron se afati ligjor i parashikuar është tejkaluar mesatarisht 2 here nga Gjyqtarja Lindita Sinanaj gjatë 2017-ës. Medota e përdorur në këtë rast nuk grumbullon të dhënë nëse vendimi është shpallur i arsyetuar në seancën përfundimtare, sikurse sugjeron paragrafi 1 i nenit 55 të ligjit Nr. 49/2012, të ndryshuar. Praktika sugjeron se në rast të vonesave mbi 7 ditë, vendimi nuk shpallet i arsyetur në seancë (ky proces i rëndësishëm ndodh më pas). Megjithatë, medoda vlerësuese në këtë rast kontraston kryesisht afatin që parashikon paragrafi 3 i nenit 55.

³ Vlerësimi nominal vs. vlerësimi tematik

Mesatarja vjetore e Gjykares Administrative të Apelit për këtë tregues në 2017-ën është 12.1 ditë. Kjo do të thotë se Gjyqtarja Lindita Sinanaj ka vonuar dorëzimin e vendimeve në sekretari më shumë se 1.1 here se mesatarja e përlogaritur për të gjithë trupën gjyqësore të marrë sëbashku (vendime përfundimtare themeli).

Vendimet më të vonuar në arsyetim/dorëzim për vitin 2017, për çështje gjyqësore me relatores Gjyqtaren Lindita Sinanajn janë ato me nr.2326,2331,2333,2336,2337,2338,2405,5343,5489,5491 (dt. seance 25.05.2017 për 6 çështjet e para,30.05.2017,14.12.2017,21.12.2017,21.12.2017), me një kohëzgjatje të përlogaritur prej 29 ditësh. Kjo e dhënë sugjeron se afati ligjor është tejkaluar 4.1 herë.

Rezulton se nga 463 vendime përfundimtare themeli gjithsej të dorëzuara në sekretari nga Gjyqtarja Lindita Sinanaj në 2017-ën, 107 rekurse janë arsyetuar/dorëzuar brenda afatit 7 ditor.

Vendimi më shpejt i arsyetuar/dorëzuar në Sekretarinë e GJAA është ai me nr.3577⁴, me 1 ditë kohëzgjatje në dorëzim.

Tabela 2 në www.gjykataehapur.al jep një paraqitje të detajuar të kohëzgjatjes në dorëzimin në sekretarinë e Gjykatës të vendimeve të arsyetuara nga Gjyqtarja Lindita Sinanaj

⁴ Respektivisht: dt seance 25.06.2017 (nr Akti 15760/10967)

I. Ngarkesa Gjyqësore, 2016

Gjykata Administrative e Apelit dha gjithsej 4738 vendime gjyqësore themeli në vitin 2016. Gjyqtarja Lindita Sinanaj rezulton se ka dhënë 467 vendime për çështje themeli në këtë gjykatë gjatë vitit 2016. Nga analiza e këtyre të dhënave rezulton se Gjyqtarja Lindita Sinanaj ka vendimuar rreth 9.8% të totalit të çështjeve të themelit në vitin 2016.

Gjyqtarja Lindita Sinanaj ka vendimuar gjatë vitit 2016 me një frekuencë prej 38.9 çështje gjyqësore në muaj mesatarisht⁵ (dosje të relatuara prej saj). Frekuenca e Gjykatës Administrative të Apelit për vendimet e çështjeve të themelit në 2016-ën rezulton të jetë rreth 394.8 çështje në muaj. Ngarkesa shpërndahet kryesisht mbi 13 anëtarë. Me një përlogaritje të thjeshtë, ngarkesa mesatare për secilin gjyqtar, për vendimet e çështjeve të themelit, është 30.3 çështje në muaj.

Kjo frekuencë, e përlogaritur vetëm për çështjet e themelit, e pozicion atë mbi mesataren e GJAA.

II. Kohëzgjatjen e shqyrtimit gjyqësor, 2016

Ligji Nr. 49/2012 *“Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar*, parashikon 30 ditë afat për shqyrtimin a ankimit gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit (neni 48⁶).

Nga vlerësimi i ndërmarrë, rezulton se mesatarja e shqyrtimit gjyqësor nga Gjyqtarja Lindita Sinanaj për çështje themeli të vendimuara prej saj në 2016 rezulton të jetë 590.9 ditë. Kohëzgjatja e shqyrtimit në këtë rast përlogaritet nga data e regjistrimit të ankimit në rregjistrat e GJAA deri në datën e vendimit të saj.

⁵ Mesatarja e vendimit në këtë rast përlogatitet si shpërndarje në 12 muajt e vitit të totalit të çështjeve. Për thjeshtësi metodologjike, muaji Gusht, I cili si rregull është muaj pushimi për gjykatën është i përfshirë me këtë mesatare, pasi ngarkesa e saj shpërndahet si rregull në muajt paraardhës dhe pasardhës..

⁶ Neni 48 **Ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit, paragrafi 2** : Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi.

Nga kontrastimi i të dhënave të mësipërme kemi një tejkalim të kësaj afati me rreth **560.9 ditë**, ose rreth 18.6 herë krahasuar me afatin që cakton neni 48, paragrafi 2, i ligjit 49/2012, të ndryshuar.

Mesatarja e kohëzgjatjes së shqyrtimit gjyqësor për të gjitha vendimet e themelit të dhëna nga Gjykata Administrative e Apelit në vitin 2016 rezulton të jetë 589.2 ditë. Krahasimi midis këtyre dy të dhënave⁷ indikon se Gjyqtarja Lindita Sinanaj ka konsumuar **1 ditë** më shumë se sa mesatarja e gjithë GJAA për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor gjatë 2016-ës.

Vonesa më e theksuar në shqyrtim gjyqësor në 2017-ën përkon me vendimin nr.3899, vendimuar nga Gjyqtarja në fjalë. Sipas të dhënave të disponuara nga INFOCIP, kjo çështje është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datë 21.01.2013 dhe është vendimuar në dt. 17.11.2016, pra pas 1397 ditësh, ose rreth 3.8 vjet. Me fjalë të tjera, afati ligjor i parashikuar në ligj është tejkaluar me 46.5 herë.

Dosja e shqyrtuar më shpejt nga Gjyqtarja Lindita Sinanaj është ajo me nr.vendimi 491, regjistruar në datë 23.02.2016 dhe e vendimuar brenda 17 ditësh, në dt.10.03.2016.

Tabela 1 në www.gjykataehapur.al ofron të dhëna të detajuara për kohëzgjatjen e shqyrtimit gjyqësor të çështjeve të vendimuara nga Gjyqtarja Lindita Sinanaj në vitin 2016, të renditura nga më e vonuara e deri tek më pak e vonuara.

III. Kohëzgjatja e dorëzimit të vendimit, 2016

Ligji Nr. 49/2012 “*Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*”, i ndryshuar, parashikon 7 ditë afat për dorëzimin e vendimit të arsyetuar në sekretarinë e GJAA. Neni 55 parashikon shprehimisht se vendimi, pavarësisht formës së gjykimit, duhet të shpallet detyrimisht i arsyetuar (paragrafi 1) dhe se, brenda 7 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore (paragrafi 3).

Sa i takon afatit të arsyetimit/dorëzimit në sekretari të dosjes së vendimuar, rezulton se Gjyqtarja Lindita Sinanaj ka një mesatare prej 10.4 ditësh gjatë vitit 2016. Kjo e dhënë sugjeron se afati ligjor i parashikuar është tejkaluar 1.4 here me shume nga Gjyqtarja Lindita Sinanaj gjatë 2016-ës. Medota e përdorur në këtë rast nuk grumbullon të dhënë nëse vendimi është shpallur i arsyetuar në seancën përfundimtare, sikurse sugjeron paragrafi 1 i nenit 55 të ligjit Nr. 49/2012, të ndryshuar. Praktika sugjeron se në rast të

⁷ Vlerësimi nominal vs. vlerësimi tematik

vonesave mbi 7 ditë, vendimi nuk shpallet i arsyetur në seancë (ky proces i rëndësishëm ndodh më pas). Megjithatë, metoda vlerësuese në këtë rast kontraston kryesisht afatin që parashikon paragrafi 3 i nenit 55.

Mesatarja vjetore e Gjykes Administrative të Apelit për këtë tregues në 2016-ën është 9.4 ditë. Kjo do të thotë se Gjyqtarja Lindita Sinanaj ka vonuar dorëzimin e vendimeve në sekretari 1.1 here më shumë se mesatarja e përlogaritur për të gjithë trupën gjyqësore të marrë sëbashku (vendime përfundimtare themeli).

Vendimi më i vonuar në arsyetim/dorëzim për vitin 2016, për çështje gjyqësore me relator Gjyqtarjan Lindita Sinanajn është ai me nr.2450 (dt. seance 08.09.2016), me një kohëzgjatje të përlogaritur prej 29 ditësh. Kjo e dhënë sugjeron se afati ligjor është tejkaluar 4.1 here.

Rezulton se nga 467 vendime përfundimtare themeli gjithsej të dorëzuara në sekretari nga Gjyqtarja Lindita Sinanaj ne 2016-ën, 131 rekurse janë arsyetuar/dorëzuar brenda afatit 7 ditor.

Vendimi më shpejt i arsyetuar/dorëzuar në Sekretarinë e GJAA është ai me nr. 4709 me 2 ditë kohëzgjatje në dorëzim.

[Tabela 2](#) në www.gjykataehapur.al jep një paraqitje të detajuar të kohëzgjatjes në dorëzimin në sekretarinë e Gjykatës të vendimeve të arsyetuara nga Gjyqtarja Lindita Sinanaj
